



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr.1, datë 14.06.2024

“Për organizimin e nëngrupeve të punës sipas përcaktimit të vendimit të krijimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”

Bazuar në nenet 24 dhe vijues të Regullores së Kuvendit dhe në pikën VII, paragrafi 2, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. Për të siguruar efikasitet sa më të mirë të veprimtarisë së Komisionit në përmbushje të misionit të tij duke mbajtur në konsideratë edhe kohën në dispozicion për ushtrimin e mandatit të Komisionit, Anëtarët e tij dhe Grupi i ekspertëve do të organizohen në 3 nëngrupe që do të angazhohen për 3 fushat kryesore të veprimtarisë së këtij komisioni. Ekspertët do të angazhohen në nëngrupe në funksion të temave përkatëse që lidhen me fushat e tyre të veprimtarisë në procesin e kryerjes së analizës dhe hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit si dhe propozimin e masave përkatëse legjislative e institucionale.
2. Nëngrupet kryesore janë: i) Mirëqeverisja; ii) Antikorrupsioni dhe iii) Sundimi i ligjit.
3. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t'a koordinuar dhe organizuar këtë proces me anëtarët e Komisionit dhe Grupin e Ekspertëve në përputhje me qëllimin e përfshirjes, përvojën dhe kontributet e tyre.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ

Miratuar me 14.06.2024